



01/Nr. 835 /2023
Data: 14.09.2023

PROCESVERBAL I DEBATI PUBLIK

Mbajtur me datë 17.08.2023 në Shkollën Fillore "Ilaz Thaçi" paralelja në fshatin Krivenik. Ashtu siç ishte paralajmëruar nëpërmes informimit debati publik filloi në ora 13:30 prezent ishin 9 qytetarë. Prej ekzekutivit ishte prezent Kryetari i Komunës z.Mehmet Ballazhi, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa znj.Lindita Ballazhi.

Takimin e kryesoj Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z.Florim Shkreta.

Rendi i Punës

1. Planifikimet Buxhetore për vitin 2024.

Florim Shkreta :- është obligim ligjor që komuna me organizuar dëgjime buxhetore për planifikimin e buxhetit për vitin 2024, për vitin 2025 dhe për vitin 2026 . Drejtoria për buxhet ka përgatitur buxhetin sipas qarkores buxhetore që është dërguar nga Ministria e Financave por është mirë si fshat me i prezantuat edhe kërkesat të cilat i keni. Kërkesat e juve do të përcillen në Kuvend të Komunës dhe brenda mundësive buxhetore komuna do të mundohet me i realizuar.

Lindita Ballazhi:-procesi i planifikimit të buxhetit fillon nga muaji Maj dhe përfundon në Muajin shtator kur të miratohet buxheti nga Kuvendi i Komunës . Gjatë fazave të planifikimit të buxhetit ne mbajmë dëgjime buxhetore me grupe të ndryshme të interesit nëpër fshatra të ndryshme duke i marr kërkesat dhe rekomandimet e qytetarëve dhe pastaj i diskutojmë me ekzekutivin e komunës dhe legjislativin. Buxheti për vitin 2024 do të jetë në lartësi prej 3,349,278.00 € këtë buxhet e kemi ndarë nëpër kategori të ndryshme buxhetore ku pjesa më e madhe e buxhetit prej 62 % shkon në kategorinë e pagave. Mallrat dhe shërbimet 524500.00 €, shpenzimet komunale 93,500.00 €, kemi të planifikuara disa projekte kapitale që prej tyre disa bëjnë pjesë në kuadër të drejtorisë për shërbime publike, Drejtorisë për zhvillim ekonomik, Drejtorisë për Urbanizëm , Drejtorisë për Arsim, Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Nëse keni ndonjë propozim për projekt kapital për vitin 2024 mund të propozoni.

Mehmet Ballazhi:- është faza buxhetore pra jemi në draft buxhet dhe 61 % e buxhetit shpenzohet për paga dhe shtesa, ndërsa pjesa tjetër është për kategoritë tjera siç i theksoj drejtoresha më lartë. Ne jemi munduar që një pjesë të mjeteve me i orientuar në projekte kapitale dhe ju përmes propozimeve të juaja mund të propozoni apo sugjeroni por duke e pasur një arsyeshmëri për projektin të cilin e propozoni pra duhet të propozoni projektet të cilat janë më prioritare.

Sefedin Thaçi:- kam dëgjuar që do të rregullohet rrjeti elektrik dhe propozoj që deri në mesin e fushës me u dërguar rrjeti. Rregullimin e rrjetit të kanalizimit. Rihapja dhe shtrimi i rrugës me zhavor deri te vendi i quajtur Mullit.

Florim Shkreta :- a keni edhe ndonjë propozim për sa i përket projekteve, nëse nuk ka ju faleminderit për pjesëmarrje.

Debati përfundoi në ora 15:41.

Procesmbajtësi
Avni Bushi

